



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:233959
Datë: 06.12.2023
Numri i dokumentit: 05020927

C.nr. 3210/23.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm - Departamenti Civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.M, nga Peja, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.M, avokat në Pejë, kundër të paditurës K.P në Pejë, me objekt kontesti Kompensimin mbi bazën e Inflacionit, me vlerë të kontestit, 1000 Euro, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mesë të palëve ndërgjyqëse në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seance me datë, 06.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me numër Nd. 2232/23 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë me datë, 24.11.2023 e lidhur në mes të paditëses H.M, nga Peja, dhe të paditurës K.P në Pejë, me objekt kontesti Kompensim mbi bazën e Inflacionit.
- II.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Ndr.nr. 2232/23, datës 24.11.2023 e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit së saj, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datën 31.10.2023, kundër të paditurës, me objekt kontesti Kompensim mbi bazën e Inflacionit, me vlerë të kontestit, 1000 Euro.

Në Qendrën e Ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datë, 24.11.2023, palët ndërgjyqës me datën, 24.11.2023, respektivisht të autorizuarit e tyre kanë arritur marrëveshjen për këtë çështje juridiko civile dhe gjykatës i është dorëzuar marrëveshja e arritur në mes palëve ndërgjyqëse, përkatësisht të autorizuarve të tyre.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës Ndr.nr. 2232/23, të datës 24.11.2023 e lidhur në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, në mes të autorizuarës të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, me objekt kontesti, Kompensim mbi bazën e Inflacionit, me vlerë të kontestit, 1000 Euro (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës, 24.11.2023, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3.3 dhe nenit, 411, 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2,3, 4,5,6,7,8, 10, 11, 12, 14, 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga të lartcekurat, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 3210/23 i dt. 06.12.2023

G j y q t a r i

Besnik Shala

Udhëzim Juridik:

Kundër këtij aktvendimi
nuk është e lejuar ankesa.